



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.54..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 20 / 03 / 2025

VENDIM

Nr.08, date 20 /03 /2025

**NË LIDHJE ME KËRKESËN E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT ME TEMËN
“MBROJTJA DHE SIGURIA E DIGAVE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”, VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) mori në shqyrtim kërkesën e Kontrollit të Lartë të Shtetit në lidhje me realizimin e një projekti të Auditimit të performancës në sektorin e digave të mëdha. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të shpreh dakordësinë për një bashkëpunim institucional me KLSH në lidhje me performancën në sektorin e digave të mëdha bazuar në Ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave” dhe një program pune zyrtar të miratuar nga të dy palët,
- 2- Të informoj Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në lidhje me kërkesën e KLSH për sigurimin e ambienteve dhe zyrave të përshtatshme për ekipin e KLSH gjatë periudhës së realizimit të projektit për auditimin e performancës në sektorin e digave të mëdha;
- 3- Bazuar në programin e mësipërm, SKDM mund të vendos në dispozicion të ekipit të KLSH të gjithë dokumentacionin zyrtar në lidhje me vendimet e KKDM dhe komunikimet e KKDM me shfrytëzuesit e digave të mëdha për performancën e sigurisë, monitorimit dhe shfrytëzimit të digave të mëdha.

Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM të ndjekë procesin e zbatimit të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

